



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 34/3 Prot.

Tiranë më 27.02.2019

REKOMANDIM

Nr. 16, datë 27.02.2019

PËR KONTROLLUESIN  
“AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1, dhe 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore”,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr. 62 datë 22.02.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore”, me objekt:

- Zbatimi i neneve 18 dhe 21 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka si objekt të veprimtarisë së saj zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e post shfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik.

Nga verifikimi i kryer në vend, rezultoi se:

1. Kontrolluesi nuk ka “Njoftuar” Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.  
Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1 të nenit 21 dhe nenit 22 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar:  
“...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë

ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.

2. Kontrolluesi nuk ka vendosur politikat e privatësisë në portalin <http://www.akbn.gov.al>, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë këtë portal. Informacioni i publikuar në “Politikat e Privatësisë”, duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, pika 1: *Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale...*” dhe Vendimit nr. 6/2013 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”.

3. Konstatohet se kontrolluesi nuk informon nëpërmjet tabelave subjektet e të dhënave “nëpunës”, “vizitorë”, etj., mbi prezencën e sistemit të video-survejmimit (CCTV), sipas Udhëzimit nr. 3/2010 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejmimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”. Modeli standard i miratuar ka për qëllim informimin e subjektet të të dhënave, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, ushtrimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave në rast të cënimit të privatësisë etj.

Konstatimi sa i përket mos informimit të subjekteve të të dhënave, mbi qëllimin e përpunimit të të dhënave, ushtrimin të të drejtave, të drejtën e ankimit etj., gjatë përpunimit e të dhënave personale imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejmimit (CCTV) nga kontrolluesi, përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit dhe Udhëzimit Nr.3/2010 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejmimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi dhe nënshkroi në prani të palëve procesverbalin e hetimit administrativ.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 21, 29, 30, 31 dhe 32 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar,

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi “Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore” në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të informojë subjektet e të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale, qëllimin e përpunimit, mjetet dhe mënyrat e përpunimit, përhapjen e të dhënave etj., nëpërmjet “Politikës së Privatësisë” në portalin zyrtar <http://www.akbn.gov.al>.
2. Kontrolluesi “Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore”, në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të ketë në vëmendje informimin e subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën

e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) nëpërmjet tabelave informuese sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri me Udhëzimin nr. 3/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".

3. Kontrolluesi "Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore" në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të kryejë pranë Zyrës së Komisionerit "Njoftimin" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës.
4. Kontrolluesi "Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore" të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
5. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 27.2.2019

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**

